

## PARADHËNIA BANKARE (OVERDRAFT) FLETË E STANDARTIZUAR E INFORMACIONIT PARAKONTRAKTOR

Zërat	Përshkrimi
<b>Teksti prezantues</b>	Ky dokument nuk përbën një ofertë ligjore detyruese. Shifrat janë dhënë në mirëbesim dhe janë një prezantim i saktë i ofertës që banka do të bëjë sipas kushteve aktuale të tregut, bazuar në informacionin e dhënë. Megjithatë, këto shifra mund të luhaten sipas kushteve të tregut. Dhënia e këtij informacioni nuk përbën detyrimin e kësaj të fundit për të akorduar kredi.
<b>1. Banka</b>	<b>BANKA KOMBETARE TREGTARE (BKT) SH.A</b> Adresa: Rruga e Vilave, Lundër 1, 1045, Tiranë, Shqipëri Adresa e web-it: <a href="http://www.bkt.com.al">www.bkt.com.al</a> Email: <a href="mailto:info@bkt.com.al">info@bkt.com.al</a> Numri i telefonit: 042 266 288
<b>2. Emri i Produktit</b>	Paradhënie Bankare (Overdraft)
<b>3. Lloji i Kredisë</b>	Kredi Konsumatore pa kolateral
<b>4. Qëllimi i produktit</b>	Nëpërmjet produktit Overdraft synohet t'i ofrohet klientëve mundësia e tërheqjes nga llogaria e tyre personale para më shumë se sa gjendja në llogarinë e tyre personale.
<b>5. Përshkrimi i produktit</b>	Ky produkt përdoret për qëllimin e parashikur në pikën 4 ku si garanci banka nuk kërkon as hipotekë dhe as dorëzanës. Ky produkt i ofrohet vetëm klientëve të cilët tërheqin pagën nëpërmjet bankës. Shlyerja e overdraftit nuk bëhet mbi bazën e një skeme të paracaktuar; klienti mund të bëjë pagesa të pjesshme të kryegjësë në çdo moment. Ndërkohë interesi për shumën e përdorur do të paguhet në fund të çdo muaji. Banka financon klientin deri në 3 paga neto ndërkohë nëse klienti është i punësuar në sektorin publik, automatikisht i aprohet një pagë neto si limit overdraftit.
<b>6. Norma e interesit (tregon llojin e interesit dhe kohëzgjatjen e periudhës së përcaktuar)</b>	<b>Monedha Lek:</b> Bono Thesari 1vj + 9% – për sektorin publik Bono Thesari 1vj + 11% – për sektorin privat  <b>Monedha Euro:</b> Euribor 1vj. + 10%  <b>Monedha USD:</b> Libor +13%  Norma e ofruar e interesit është e ndryshueshme sipas luhatjeve të Bonove të Thesarit, Euribor dhe Libor me afat 1-vjeçar, çdo fund viti kalendarik. Aplikanti do të informohet nëpërmjet telefonit, postës elektronike ose me postë për çdo ndryshim në kushtet dhe termat e kontratës së overdraftit.
<b>7. Norma efektive e interesit</b>	Norma efektive e interesit (NEI) percakton koston totale që klienti do të përballojë për kredinë e marrë me kushtin që kredia do të shlyhet për periudhën e rënë dakord, palët i përmbahen kushteve të përcaktuara në kontratë dhe interesi dhe shpenzimet e tjera mbeten të pandryshuara deri në fund të maturimit të kredisë. NEI është e barabartë me Normën nominale të përcaktuar në pikën 6.
<b>8. Vlera e kredisë dhe monedha e ofruar</b>	<b>Shuma maksimale</b> – deri në 3 paga neto por jo më shumë se 500,000 Lek / 5,000 Euro / 5,000 USD <b>Monedha e kredisë</b> – Lek / Eur/ USD
<b>9. Kohëzgjatja e kontratës së kredisë për Overdraftit</b>	Derisa klienti të ndërpresë marrëdhëniet e punës me punëdhënësin dhe paga nuk paguhet më nëpërmjet bankës.
<b>10. Çelja dhe Lëvrimi i Overdraftit</b>	- Limiti i Overdraftit do t'i akordohet Klientit në llogarinë e pagës dhe përdorimi i tij do të krijojë një tepricë debitore në këtë llogari.
<b>11. Numri dhe frekuenca e pagesave</b>	Pagesat mund të kryhen në kohë dhe sasi të ndryshme sipas preferencave të klientit
<b>12. Vlera e çdo kësti për shlyerjen e kredisë për Overdraft</b>	Nuk parashikohet shlyerje me këste. Interesi për llogaritë çdo fund muaji për shumën e përdorur dhe numrin e ditëve që është përdorur kjo shumë. Ky interes debitohet në llogarinë e klientit në fund të muajit. Kryegjësja dhe Interesi i për llogaritë mund të paguhet me pjesë sipas dëshirës së klientit në çdo moment.

<b>13. Tabela ilustrative e amortizimit te kredisë (plani I shlyerjeve)</b>	Interesi = $\sum$ Limit i përdorur * Normë Interesi/360 * Ditët e përdorura
<b>14. Kosto shtesë të pakthyeshme në rastin kur aplikohen të tilla</b>	Nuk ka.
<b>15. Kosto shtesë të tjera</b>	Nuk ka.
<b>16. Shlyerja para afatit të maturimit (kur është e aplikueshme)</b>	Nuk ka.
<b>17. Njoftimi zyrtar midis paleve</b>	<p>Të gjithë njoftimet, komunikimet midis palëve do të bëhen me shkrim të dorëzuara personalisht ose me postë të regjistruar (rekomande) në adresën e përcaktuar në Kontratën e Kredisë, ose kur është e mundshme me një mjet të qëndrueshëm komunikimi (e-mail të përcaktuar në Kontratën e Kredisë, disketë, CD-ROM, DVD, Kuti Postare).</p> <p>Kredimarrësi deklaron dhe pranon që të gjithë llojet e njoftimeve të bëra në adresat e deklaruara do të konsiderohen si të marra nga ai. Kredimarrësi mund t'i paraqesë Bankës reklamimet e tij, për sa njoftohet, brenda një afati prej 15 ditësh kalendarike.</p> <p>Kredimarrësi është i detyruar që për çdo ndryshim në adresat e tij të njoftojë Bankën brenda 15 diteve kalendarike për këtë ndryshim. Për sa kohë që ai nuk ka njoftuar adresën e re, Kredimarrësi nuk ka të drejtë të kundërshtojë njoftimet e bëra në adresën e mëparshme.</p>
<b>18. E drejta e tërheqjes nga kontrata e kredisë</b>	Klienti ka të drejtë të tërhiqet nga Kontrata e Overdraftit brenda një periudhe kalendarike 14 ditore. Ky afat fillon nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate. Në rastet kur limiti i Overdraftit është akorduar në llogarinë e klientit dhe ky i fundit ushtron të drejtën për t'u tërhequr nga Kontrata e Overdraftit, atëherë klienti pranon dhe merr përsipër të shlyejë Limitin e Overdraftit të përdorur (kryegjënë) dhe gjithë detyrimet për interesa dhe /ose penalitete, si dhe shpenzime të tjera të mundshme të bankës të krijuara me palë të treta për efekt të përdorimit të këtij limiti.
<b>19. Skemat e brendshme të ankimit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ankesë me shkrim pranë çdo dege</li> <li>- Vizitë pranë çdo dege</li> <li>- Nëpërmjet telefonit (+355 42 266 288) call center</li> <li>- Nëpërmjet adreses elektronike <a href="mailto:info@bkt.com.al">info@bkt.com.al</a></li> </ul>
<b>20. Penalitete të tjera</b>	Në rast se tejkalohe limitin e Overdraftit i aprovuar nga banka, klienti do të paguajë një norme penaliteti në vlerën 4(katër)% mujore për limitin në Lek dhe 3(tre)% mujore për limitin në Euro ose USD, mbi shumën e tejkaluar, e cila do të debitet në llogarinë e klientit në fund të muajit. Për llogaritja e penalitetit do të fillojë ditën e parë pas ditës së tejkalimit të limitit. Penaliteti do të llogaritet mbi shumën e tejkaluar të limitit dhe për sa ditë klienti e ka tejkaluar këtë limit.
<b>21. Periudha kohore e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor</b>	Periudha kohore e vlefshmërisë së informacionit parakontraktor është 7(shtatë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të këtij informacioni nga klienti.

\_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_  
(Qyteti, dd,mm,vvvv)

\_\_\_\_\_  
Klienti: Emër Mbiemër  
(Firma)